



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Seanca plenare

Seanca nr. 02-20/07-06

Prishtinë, më 6 prill 2006

Ndërtesa e Kuvendit, salla e seancave plenare.

PROCESVERBAL

Seancën e drejtoi **Kolë BERISHA**, kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi **Xhavit HALITI**, anëtar i Kryesisë.

Kryetari konstatoi se në seancë janë të pranishëm 83 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë

REND DITE:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të 24 marsit 2006;
3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për inspektoratin e produkteve të ndërtimit;
4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për institucionet e kulturës;
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për mbrojtjen kundër zjarrit;
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për kodin e mirësjelljes së nëpunësve civilë;
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndërprerjen e shtatzënisë;
8. Shqyrtimi i propozimit të Grupit Parlamentar të LDK-së për zëvendësimin e anëtarëve të komisioneve parlamentare;
9. Propozimi i Grupit Parlamentar të LDK-së për emërimin e z. Sabri Hamiti, anëtar të Komisionit Ad Hoc për Media, në vend të anëtarit të deritanishëm z. Fatmir Sejdiu;
10. Propozimi i rendit të ditës për seancën plenare të 13 prillit 2006.

Kryetari i informoi deputetët e Kuvendit për qëllimin dhe rendin e ditës së kësaj seance.

1. Miratimi i rendit të ditës

Për fjalë u paraqiten këta deputetë:

Besa Gaxherri (LDK) ngriti çështjen e pensioneve të ish-minatorëve dhe kërkoi nga Qeveria e Kosovës të mos zvogëlohen pensionet e tyre.

Teutë Hadri (PDK) kërkoi që në seancën e sotme të diskutohet për përgatitjet e Qeverisë së Kosovës për parandalimin e sëmundjes së etheve hemorragjike.

Flora Brovina (PDK) kërkoi që në seancën e sotme të diskutohet për problemet e shëndetësisë dhe Qeveria përparësi t'u japë përgatitjes së ligjeve primare.

Kamber Kamberi (LDK) ngriti çështjen e zbardhjes së fatit të personave të zhdukur dhe të pagjetur. Ai kërkoi që 27 prilli të shpallet Dita e të Zhdukurve.

Bajram Rexhepi e mbështeti kërkesën e deputetes Teutë Hadri.

Kryetari tha se kërkesat e deputetëve Besa Gaxherri, Flora Brovina dhe Kamber Kamberi duhet t'i adreson Qeverisë së Kosovës, ndërsa kërkesën e deputetes Teutë Hadri e hodhi në votim. Rezultati ishte si vijon:

Për-----45,

Kundër-----29.

Kryetari konstatoi: Kuvendi me shumicë votash miratoi kërkesën e deputetes Teutë Hadri që rendit të ditës, të propozuar për këtë seancë t'i shtohet edhe pika 11: Përgatitjet e Qeverisë së Kosovës për parandalimin e sëmundjes ethe hemorragjike.

2. Miratimi i procesverbaleve të seancave plenare të 16 dhe 24 marsit 2006

Procesverbalet e seancave plenare të 16 dhe 24 marsit 2006 u miratuan pa vërejtje.

Deputeti Mahir Jagxhillar pati vërejtje në procesverbalin e 10 marsit 2006. Ai shtoi se këtë vërejtje a ka bërë me shkrim me rastin e miratimit të këtij procesverbali. Vërejtja ishte se në procesverbal, në pikën e pestë të vendimit të Kuvendit për zgjedhjen e Qeverisë së Kosovës thuhej: ..."zëvendësministri i Ministrisë së Drejtësisë do të zgjidhet pas marrjes së propozimit nga Qeveria, në konsultim me LSKM-në", kurse duhet të jetë: **"Zëvendësministri i Ministrisë së Drejtësisë do të zgjidhet nga komuniteti turk"**.

Kuvendi miratoi vërejtjen e deputeti Mahir Jagxhillar.

3. Shqyrtimi i dytë i Projektligji për inspektoratin e produkteve të ndërtimit

Kryetari i informoi deputetët e Kuvendit lidhur me procedurat e shqyrtimit të këtij projektligji, si dhe për raportet e komisioneve kryesore dhe të Komisionit Përgjegjës – Raportues.

Ai i hodhi në votim , veç e veç, amendamentet e Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11 dhe 12.

Pastaj, kryetari i hodhi në votim Projektligjin me amendamente në tërësi. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----72;

Kundër----- 1.

Kryetari konstatoi: **Kuvendi** i Kosovës me shumicë votash miratoi Ligjin për inspektoratin e produkteve të ndërtimit

4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për institucionet e kulturës

Kryetari i informoi deputetët e Kuvendit lidhur me procedurat e shqyrtimit të këtij projektligji dhe për raportet e komisioneve kryesore dhe të Komisionit Përgjegjës – Raportues.

Ai i hodhi në votim, veç e veç, amendamentet e Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9,10,11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20 dhe 21.

Kryetari e hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara. Rezultati ishte si vijon:

Për----- 63.

Kundër----- 1.

Kryetari konstatoi: **Kuvendi** i Kosovës me shumicë votash **miratoi** Ligjin për institucionet e kulturës.

5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për mbrojtjen kundër zjarrit

Kryetari i informoi deputetët e Kuvendit lidhur me procedurat e shqyrtimit të këtij projektligji, si dhe për raportet e komisioneve kryesore dhe të Komisionit Përgjegjës – Raportues.

Ai i hodhi në votim, veç e veç, amendamentet e Komisionit për Gatishmëri dhe Emergjencë.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 5, 6, 7, 8, 9,10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23 dhe 24.

Kryetari e hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara. Rezultati ishte si vijon:

Për----- 69.

Kundër----- 1.

Kryetari konstatoi: **Kuvendi** i Kosovës me shumicë votash **miratoi** Ligjin për mbrojtjen kundër zjarrit.

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për kodin e mirësjelljes së nëpunësve civilë

Kryetari e ftoi sponsorin ta arsyetonte këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Zëvendësministri Mark Komani, në emër të Qeverisë së Kosovës, e arsyetoi nevojën për normimin e kësaj fushe me ligj të ri
Në vazhdim, zëvendësministri **Komani** shpjegoi materien, objektivat, mënyrën e realizimit, efektet buxhetore, si dhe faktorët kryesorë për zbatimin e këtij projektligji.

Pas arsyetimit të këtij projektligji nga zëvendësministri Komani, kryetari e hapi **diskutimin** për shqyrtimin e tij, në parim.

Nekibe Kelmendi, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, tha se ky projektligj i përngjan një akti nënligjor. Vetë titulli i tij është kundërthënës. Duhet të jetë: “Projektligji për mirësjelljen e nëpunësve civilë”.

Ajo shprehu mendimin se propozuesi duhet ta tërheqë këtë projektligj nga procedura e mëtejme.

Sevdije Halimi, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, tha se Qeveria e Kosovës duhet t’i propozojë Kuvendit ligjet bazike. Para këtij projektligji është dashur ta propozoj Projektligjin për punë.

Në këtë projektligj nuk bëhen dallimet ndërmjet pozitive politike dhe stafit civil në administratën publike të Kosovës.

Ky projektligj duhet t’i kthehet sponsorit.

Nazim Jashari, në emër të Grupit Parlamentar të ORA-s, propozoi që ky Projektligj t’i kthehet Qeverisë së Kosovës.

Ymer Halimi, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së ka shumë vërejtje në përmbajtjen e këtij projektligji. Me këtë projektligj synohet të krijohet një administratë servile, ndërsa neve na nevojitet një administratë profesionale dhe e paanshme.

Ky projektligj duhet t’i kthehet sponsorit.

Xhezair Murati, në emër të Grupit Parlamentar 6+, propozoi që ky projektligj t’i kthehet sponsorit.

Ferid Agani, në emër të Grupit Parlamentar “Për Integrim” propozoi që ky projektligj të tërhiqet na procedura e shqyrtimit të mëtejme, ngase ky i përngjan një akti nënligjor.

Ramadan Kelmendi (LDK) paraqiti disa vërejtje dhe sugjerime për përmirësimin e titullit dhe të përmbajtjes së këtij projektligji.

Naxhije Doçi (LDK) tha se e mbështet këtë projektligj.

Fatmire Mulhaxha-Kollçaku (ORA) tha se me këtë projektligj nuk mbrohen të drejtat dhe interesat e shërbyesve civilë.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari e ftoi propozuesin të deklarohej lidhur me procedimin e mëtejshëm të këtij projektligji.

Zëvendësministri **Mark Komani** kërkoi nga deputetët e Kuvendit që ta miratonin këtë projektligj.

Kryetari e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati ishte si vijon:

Për----- 12;
Kundër----- 52.

Kryetari konstatoi: **Kuvendi** i Kosovës me shumicë votash mori këtë

V E N D I M

1. Kuvendi i Kosovës nuk e miratoi në parim Projektligjin për kodin e mirësjelljes së nëpunësve civilë.

7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndërprerjen e shtatzënisë

Kryetari e ftoi sponsorin ta arsyetonte këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Ministri Sadik Idriz, në emër të Qeverisë së Kosovës, arsyetoi nevojën e normimit të kësaj fushe me ligj të ri

Në vazhdim, ministri **Idrizi** shpjegoi materien, objektivat, strukturën, mënyrën e realizimit, si dhe efektet buxhetore të zbatimit të këtij projektligji.

Pas arsyetimit të këtij projektligji nga ministri **Idrizi**, kryetari e hapi diskutimin për shqyrtimin e tij, në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: **Teutë Hadri, Nurishahe Hulaj, Zylfije Hundozi, Shpresa Murati, Fatmire Mulhaxha, Ferid Agani, Flora Brovina, Nekibe Kelmendi, Nafije Berisha dhe Gjulshen Berisha**, që i janë bashkangjitur stenogramit.

Pas këtyre diskutimeve, **kryetari** e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati ishte si vijon:

Për----- 59;
Kundër----- 5.

Kryesuesi konstatoi: **Kuvendi** i Kosovës me shumicë votash e miratoi **në parim** Projektligjin për ndërprerjen e shtatzënisë.

Kuvendi i ngarkoi komisionet e veçanta dhe Komisionin për Shëndetësi, Punë dhe Çështje Sociale - Komision Përgjegjës - Raportues për ta shqyrtuar këtë projektligj, brenda dy muajve dhe t'ia paraqesin Kuvendit raportin për miratim

8. Shqyrtimi i propozimit të Grupit Parlamentar të LDK-së për zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare

Kuvendi, pas shqyrtimit të këtij propozimi, mori këtë

V E N D I M

1. Deputeti **Ali Sadrija** emërohet anëtar i Komisionit për Buxhet dhe Financa, në vend të deputetit Behxhet Brajshori.
2. Deputeti **Sadudin Berisha** emërohet nënkryetar i parë i Komisionit për Çështje Gjyqësore, Legjislacion, Kornizë Kushtetuese, Barazi Gjinore dhe Peticione, në vend të deputetit Kolë Berisha.
3. Deputetja **Nekibe Kelmendi** emërohet anëtare e Komisionit për Çështje Gjyqësore, Legjislacion, Kornizë Kushtetuese, Barazi Gjinore dhe Peticione, në vend të deputetit Sadudin Berisha.
4. Deputeti **Nexhat Daci** emërohet anëtar i Komisionit për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Integritet Evropian, në vend të Fatmir Sejdiut.
5. Deputeti **Ibush Jonuzi** emërohet kryetar i Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë dhe Telekomunikacion, në vend të deputetit Fatmir Rexhepi.
6. Deputeti **Zef Morina** emërohet anëtar i Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri Energjetikë dhe Telekomunikacion, në vend të deputetit Ibush Jonuzi.
7. Deputeti **Fadil Gashi** emërohet anëtar i Komisionit për Gatishmëri dhe Emergjencë, në vend të deputetit Fadil Kryeziu.

9. Propozimi i Grupit Parlamentar të LDK-së për emërimin e z. Sabri Hamiti anëtar të Komisionit Ad Hoc për Media, në vend të anëtarit të deritanishëm z. Fatmir Sejdiu

Kuvendi, pas shqyrtimit të këtij propozimi, mori këtë

V E N D I M

1. Deputeti **Sabri Hamiti** emërohet anëtar i Komisionit Ad Hoc për Media, në vend të anëtarit të deritanishëm, Fatmir Sejdiu.

10. Përgatitjet e Qeverisë së Kosovës për parandalimin e sëmundjes ethet hemorragjike

Ministri **Sadik Idrizi** para deputetëve të Kuvendit paraqiti kronologjinë e zhvillimit të sëmundjes ethet hemorragjike në Kosovë, si dhe numrin e të sëmurëve nga kjo sëmundje në periudhën e kaluar.

Në vazhdim ministri Idrizi foli për masat që kanë marrë Ministria e Shëndetësisë dhe Instituti i Shëndetësisë Publike për parandalimin e sëmundjes ethet hemorragjike.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me parandalimin e sëmundjes së ethet hemorragjike dhanë këta deputetë: **Teutë Hadri, Fatmire Mulhaxha-Kollçaku, Gjylnaze Sylja, Jonuz Kastrati dhe Nurishahe Hula**, që i janë bashkangjitur stenogramit

11. Miratimi i rendit të ditës të seancës së radhës

Kuvendi me propozimi e Kryesisë miratoi rendin e ditës të seancës plenare të 13 prillit 2006 si vijon:

1. Shqyrtimi i implementimit të standardeve për Kosovën,
2. Shqyrtimi i procesit të privatizimit në Kosovë,
3. Shqyrtimi i informatës për parandalimin e gripit të shpendëve.

Kryetari e deklaroi seancën të mbyllur në orën 14:25 minuta.

E hartoi

Spektori i Çështjeve Plenare dhe Procedurale

Kryetari i Kuvendit të Kosovës
Kolë BERISHA
